

**RENDI I DITËS**

**Projektakti “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë  
05.02.2022 të Partisë Demokratike”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, E.Mema
- **Parti Politike:** PD, LSI

**Z. L. Braho:** Mirëmëngjes! Çelim seancën për verifikimin paraprak në lidhje me Kërkesën Ankimore nr. 2, të datës 05.02.2022, që është depozituar në KQZ në datën 05.02.2022, në orën 12:45, të subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 46, të datës 4 shkurt 2022, “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e Koalicionit “Shtëpia e Lirisë” për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”, ka vendosur: të regjistrojë si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie që do të zhvillohen në datë 6 Mars 2022, koalicionin e partive politike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë”, me shkronjat nistore Sh-L. Partia udhëheqëse e koalicionit është Lëvizja Socialiste për Integrim. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ndaj tij mund të bëhet ankim. Partia Demokratike e Shqipërisë, siç e cituam ka depozituar ankim në lidhje me këtë vendim të Komisionerit. Në zbatim të nenit 12, të rregullores për mënyrën e

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.07.02.2022*

funksionimit dhe zhvillimit të seancave të KAS-it, në datë 05.02.2022 është hedhur shorti dhe jam caktuar unë si relator i kësaj kërkesë ankimore. Seanca e sotme është seanca e verifikimit paraprak dhe zhvillohet në zbatim të neneve 17 dhe 18, të rregullores për zhvillimin e seancave në KAS dhe nenit 130 të Kodit Zgjedhor që verifikon elementet e kompetencës së KAS-it për shqyrtimin e ankimit, legjitimitetit të ankuesit dhe respektimit të afateve ligjore për ankimin. Përpara se t'i japim fjalën përfaqësuesit të administratës të KQZ-së, Sekretarit të Përgjithshëm, prezenca e palëve, ju lutem një prezantim!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Mirëmëngjes zoti Braho! Mirëmëngjes të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në emër të Partisë Demokratike do të jem unë Marash Logu. Autorizimi përkatës është depozituar në fakt, që në fillim të procesit zgjedhor, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Besoj që administrata mund ta konfirmojë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Përshëndetje të nderuar anëtarë të KAS-it! Duke qenë se është seanca e parë që unë zhvilloj për vitin 2022 pranë këtij Komisioni, ju uroj ju dhe familjeve tuaja një vit sa më të mbarë. Unë jam Altin Kaziaj, përfaqësuesi ligjor i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe po ashtu përfaqësuesi ligjor i Koalicionit "Shtëpia e Lirisë", faleminderit!

**Z. L. Nuraj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Unë jam Ledio Nuraj, përfaqësues zëvendësues, i Koalicionit "Shtëpia e Lirisë", i regjistruar me shkresën, të cilën e kemi depozituar pranë administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.07.02.2022*

**Z. L. Braho:** Faleminderit! Sot jemi 4 anëtarë të pranishëm këtu në sallë dhe anëtari Elvis Çefa po na ndjek nëpërmjet platformës Zoom. Pra, trupa konsiderohet e plotë me 5 anëtarë. Atëherë zoti Merkaj, në lidhje me elementet e nenit 130 të Kodit Zgjedhor, çfarë mund të na thoni?

**Z. Y. Merkaj:** Pasi është depozituar kërkesa ankimore nga Partia Demokratike e Shqipërisë është zhvilluar seanca për caktimin e relatorit. U caktua dhe seanca për zhvillimin e seancës përgatitore. Kemi verifikuar elementët formalë dhe përmbajtësore të ankimit dhe janë në përputhje me nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Kërkesa ankimore përmban elementët e mëposhtëm: emrin e plotë të subjektit zgjedhor ankues me adresën e tij, referimin e vendimit që ankimohet, bazën ligjore, përshkrimin e shkurtër të shkeljes së pretenduar, përshkrimin e fakteve dhe argumenteve dhe dispozitave ligjore tek të cilët mbështetet ankimi. Gjithashtu vërtetimi i provave, të cilët kërkohen të merren gjatë shqyrtimit të ankimit dhe datën me firmën e ankimuesit. Gjithashtu është në përputhje me nenin 130 të Kodit Zgjedhor, pasi është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rastin konkret, e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për shqyrtimin e ankimit. Legjitimitimi i ankuesit pasi është subjekt zgjedhor dhe ka të drejtën e ankimit, si dhe respektimi i afeteve ligjore është bërë brenda afatit të përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Kështu që kërkesa e tyre i plotëson si anën formale ashtu dhe përmbajtësore të ankimit, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Mundem zoti Braho?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. L. Braho:** Atëherë, palët, po!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Në relacionin që bëri...

**Z. L. Braho:** Ke në lidhje me themelin apo në lidhje me ...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Jo në lidhje me bazën ligjore të përdorur nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, lidhur me, të themi, legjitimitetin paraprak të ankuesit për t'u legjitimuar në një seancë administrative pranë këtij komisioni. Nuk e di se ku e gjeti në përputhje me nenin 130, pika 1, germa "b", Sekretari i Përgjithshëm, duke qenë se ky institucion...

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj, me qetësi...


**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Më falni ta mbaroj, nuk të zgjas shumë...

**Z.L.Braho:** Jo pra, se ka radhë procedura. Flet njëherë ankuesi, se mbase ta mbush mendjen ankuesi...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Jo, por nuk duhet të ishte shprehur si Sekretar i Përgjithshëm, duke pasur dhe precedentë të mëparshëm të Kolegjit Zgjedhor...

**Z. L. Braho:** Tani ai u shpreh...

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Lidhur me legjitimitetin..


**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj! Mos e fillojmë me kaq vrull që me mëngjes. Do të vijë radha siç të ka ardhur gjithmonë, do të vijë radha dhe sot. Të flasë zoti Logu lidhur me elementët, mbasi ka konstatuar dhe ai ndonjë problematikë nga fjala e Sekretarit të Përgjithshëm dhe me konsensus arrini të bindeni. Po zoti Logu! Vetëm për këto elementet, jo për themelin!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Braho! Siç ju e thatë me të drejtë, kjo është një seancë paraprake ku shqyrtohen vetëm elementët formalë të kërkesës sonë, ashtu siç me të drejtë e relatoi dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ne vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në përputhje dhe përmban të gjithë elementet e parashikuara nga neni 126 dhe 130 i Kodit Zgjedhor. Në këtë kuptim vlerësojmë se duhet të kalojë për shqyrtim në seancë nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Tani e ka radhën zoti Kaziaj, në qoftë se doni sërish t'i listoni ato problematikat.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Atëherë, faleminderit zoti relator! Të nderuar anëtarë të KAS-it! Unë jam njohur me kërkesën ankimore ditën e djeshme rreth orës 17:06, nëpërmjet një komunikimi të bërë në rrjetin social *whatsapp* nga, besoj një punonjës i administratës së KQZ-së. Pavarësisht faktit të afatit kohor, kur më është dërguar kërkesa, e cila ishte jo në përputhje të themi me vetë parashikimet dhe me logjikën e thjeshtë për t'u përgatitur në mbrojtje të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 07.02.2022*

interesit tonë të ligjshëm. Jam njohur me përmbajtjen e saj, siç thashë dhe nga ajo rezulton se: kërkesa ankimore, i nderuar zoti relator është depozituar për shqyrtim në KAS. Ka elementë të mangët të karakterit të formës së parashikuar nga vendimi nr. 3/2020 i Komisionit Rregullator, që është rregullorja juaj e funksionimit dhe zhvillimit të seancave, pra të këtij komisioni. Elementi më thelbësor mungues është ai i mospërbushjes së kushteve të modelit nëpërmjet të cilit është bërë ankimi, sipas formatit detyrues të kërkesës ankimore, modelit KA bashkëlidhur vendimit nr. 3/2020 të Komisionit Rregullator. Në këtë kërkesë ankimore mungojnë elementë të parashikuara në nenin 10, pika 1, si dhe elementë të pikës 2 të këtij neni, të parashikuara në germën “dh”. Pra, jo vetëm forma, por dhe përmbajtja e kërkesës ankimore depozituar nga subjekti zgjedhor PD, që lidhet me elementë, si e drejta e ankimit dhe legjitimiteti për të ushtruar këtë të drejtë nuk është në përputhje me nenin 9 të rregullores miratuar me vendimin e Komisionit Rregullator, nr. 3/2020. Kërkesa eksplicite të Kodit Zgjedhor, i nderuar zoti relator, të parashikuara këto në kreun e pestë, neni 124, ku parashikohet e drejta e ankimit, në ankimin e bërë nga subjekti zgjedhor PD, nuk përmbushen. Pra, është e qartë që ligjvënësi në këtë nen ka parashikuar që ankimi të paraqitet sipas pikës 1 të këtij neni. Në rast të cënimit të interesit të tyre të ligjshëm, thotë. Tashmë është e njohur dhe vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor, në mos gaboj në vitin 2019, lidhur me interpretimin se cili subjekt mund të ketë interes të ligjshëm, kështu që besoj se ju jeni në dijeni të kësaj. Ose në pikën 5 të këtij neni kur i është refuzuar kërkesa për regjistrim. Pra, nuk ndodhemi as në kushtin e parë që PD, nëpërmjet përfaqësuesit të saj ka bërë ankim dhe na siguron, na garanton dhe tregon realisht se çfarë ka si interes të ligjshëm. Nuk ndodhemi as në kushtin e dytë që ka parashikuar ligjvënësi, që i është refuzuar kërkesa për regjistrim. Pra, cili është interesi i ligjshëm i PD-së lidhur me vendimmarrjen e KQZ-së, për regjistrimin e koalicionit

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*


*Dt.07.02.2022*

“Shtëpia e Lirisë”? Tashmë ju e dini fare qartë, jeni të gjithë juristë që nga praktika, vetë interesi për të ngritur një pretendim të shkelur në një organ administrativ ose gjyqësor është një element shumë i rëndësishëm dhe konsiston në interesin për të marrë nga organi administrativ ose gjykata, vendimin e kërkuar. Interesi i ligjshëm është një interes procedural, i cili lind nga domosdoshmëria për të arritur nga procesi mbrojtjen e një interesi material dhe për këtë arsye pala i drejtohet organit administrativ ose gjykatës në rast, duke kërkuar njohjen e cënimit të një interesi dhe rivendosjen e së drejtës së shkelur. A po ushtron PD nëpërmjet këtij ankimi të drejta apeluese për mosregjistrim si subjekt zgjedhor, në zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022? Përgjigjja është jo! Subjekti PD nëpërmjet këtij ankimi nuk mund dhe nuk duhet të legjitimohet se i mungojnë elementet thelbësore të interesit të ligjshëm, elementë pa të cilat mungon dhe vetë veprimi procedural, nëpërmjet të cilit vihet në lëvizje ky komision dhe për të shprehur në lidhje me kërkesën e tyre. Mendojmë që tashmë komisioni i ka të gjithë ato dokumente administrativë dhe vetë vendimmarrjen nr. 46, datë 04.02.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku është vendosur regjistrimi i koalicionit në përputhje me nenin 65, të Kodit Zgjedhor. Unë kam dhe më shumë, por për momentin këto janë argumentet të themi të karakterit të formës dhe të përmbajtjes, pse në seancë paraprake, ju i nderuar zoti relator dhe ju të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, nuk duhet të merrni në shqyrtim këtë kërkesë, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Kaziaj! Po zoti Logu!

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Braho! Sa i përket formës ose përmbajtjes së ankimit, edhe në qoftë se i referohemi nenit 126, edhe në qoftë se i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

referohemi nenit 130 të Kodit Zgjedhor, por besoj edhe nenit 10 të rregullores së posaçme për veprimtari të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve. Ankimi që ne kemi paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përmban në fakt të gjitha elementet e kërkuara qoftë nga ligji, ashtu dhe nga ato nënligjore të nxjerra nga KQZ. Nuk do të doja t'i citoja, por nuk dëgjova nga ana e përfaqësuesit të subjektit zgjedhor, Lëvizja Socialiste për Integrim asnjë mangësi në elementet që përmban kërkesa jonë ankimore e paraqitur pranë KQZ-së. Pra, ka të dhënat identifikuese, ka objektin, ka identifikimin e aktit, ka përshkrimin e shkeljeve, ka provën që ne i kemi bashkëlidhur dhe vlerësojmë se është me rëndësi për këtë proces, ka datën dhe nënshkrimin e subjektit. Kështu që në këtë kuptim besoj që është tashmë ezauruar sa i përket formës dhe përmbajtjes së ankimit që ne kemi paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Së dyti i nderuar, sa i përket interesit të ligjshëm që ka subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë, kjo në fakt është pranuar. Pra, interesi ynë është pranuar edhe në përmbajtjen e vendimit nr. 46, datë 4 shkurt 2022, të cilin e kundërshtojmë dhe kam parasysht këtu në faqen 4 të saj, që thotë “e çmoj të bazuar pretendimin në lidhje me atë se kërkesë e LSI-së cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë”. Pra, edhe në vendimin me të cilët sigurisht jam dakord, përfaqësuesi i subjektit zgjedhor, Lëvizja Socialiste për Integrim është pranuar interesi legjitim që ka Partia Demokratike sa u përket disa elementeve, të cilat ne i vlerësojmë se vijnë në kundërshtim me ligjin në kërkesën e bërë nga ana e subjektit, Lëvizja Socialiste për Integrim. Për më tepër qartazi, ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë edhe në ankimin tonë, por nuk do të doja të ndalesha në themel. Në fakt kjo seancë nuk është e tillë. Ka referenca të qarta qoftë në kërkesën e depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu edhe në marrëveshje që bëjnë referencë tek Partia Demokratike e Shqipërisë, me qëllim ndoshta, ose

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

ndoshta përfaqësuesi mund ta shpjegojë, për të krijuar më pas edhe konfuzion tek zgjedhësi. Ne në fakt kemi paraqitur edhe një provë që e vlerësojmë që i shërben këtij argumenti. Në qoftë se do të na lejohet do të paraqesim edhe prova të tjera, të cilat pikërisht, fakti që është regjistruar dhe pranuar një kërkesë e tillë dhe një marrëveshje e tillë koalicioni, kanë prodhuar disa pasoja që shkaktojnë konfuzion tek zgjedhësit. Mendoj që interesi i ligjshëm i çdo subjekti zgjedhor, por edhe i të gjitha subjekteve së bashku ashtu dhe administratës së KQZ-së, është që zgjedhësi në ditën e votimit, të jetë i qartë lidhur me subjektin që do të votojë, subjektin politik që ai mendon të votojë dhe me kandidatin që kërkon të votojë. Kjo qartësi nëpërmjet disa elementëve paligjshmërie që ne do të kemi mundësi t'i parashtrojmë në seancat e tjera, mendojmë se janë cënuar dhe ky është interesi i ligjshëm i Partisë Demokratike. E ripërsëris i pranuar edhe në vendimin nr. 46, datë 4 shkurt 2022, nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me të cilin kanë rënë dakord edhe përfaqësuesit e LSI-së.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Po, zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Po, patjetër, se ishte replikë për shkak se nuk ishte i vëmendshëm në momentin që unë citoj normat, të cilat janë të themi ndaluese...

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj! Qëndrojmë tek debati për interesin e ligjshëm se për...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Patjetër!

**Z. L. Braho:** Se ai është prioritet..

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** ...dhe tek debati i formës zoti Braho. Se ju merrni në shqyrtim një ankim pa formë, do të thotë që ju shkelni një dispozitë të një akti rregullues.

**Z. L. Braho:** Për kë formë e ke fjalën, që nuk është tabela?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Për formën e ankimit. Në qoftë se do ta thjeshtëzosh, nuk është tabela, nuk dua ta bëj kaq të thjeshtë, se nuk është tabela.


**Z. L. Braho:** Unë nuk po e thjeshtësoj! Ti je i rregullt këtu në KAS dhe di që ka pasur dhe raste të tjera të ngjashme.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Por, unë s'po them nuk është tabela zoti Braho! Përveç tabelës që është model i rregulluar që ju kapërceni, domethënë një vendimmarrje të një komisioni rregullues. Po t'i referohemi nenit 10, pika 2, germa "dh" thotë "tregimin e provave që paraqiten, që kërkohen të marrë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit, burimin e tyre, si dhe numrin e tyre". Ku është e parashikuar kjo në ankim? Në cilën pjesë është e parashikuar kjo në ankim?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po në qoftë se s'ka?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Të lutem Logu, tani po ju përgjigjem juve!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj e bëre pyetjen. KAS-i kur të marrë vendimin do të shqyrtojë dhe pretendimin tuaj.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Sjell në vëmendje të zotit Logu, të kolegut Logu dhe tuajin si komision shqyrtues të kësaj kërkesë ankimore, që nuk është në përputhje me vetë nenin 9 të rregullores, pika 8 kur thotë “kundër akteve të Komisionerit lejohet ankim në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë interes të ligjshëm për çështjen e objekt gjykimit”. Cili është demonstrimi i interesit të ligjshëm nga subjekti politik që përfaqëson zoti Logu?

**Z. L. Braho:** Zoti Logu e tha. Kurse ne do të flasim me vendim, se s’besoj se po pret përgjigje prej nesh tani...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Jo unë s’po pres përgjigje prej jush, por unë po vë në vëmendje tuajën si komision.

**Z. L. Braho:** Jemi të qartë! Kolegët kanë ndonjë pyetje? Po zoti Rusmali!

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Çështja e legjitimitetit të palës kur është bërë shqyrtimi i kërkesës së koalicionit nga ana e Komisionerit, është diskutuar? Subjektit Partia Demokratike?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Ishte pyetje për mua zoti Rusmali?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. I. Rusmali:** Po, për ju!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Është kundërshtuar nga ana ime si përfaqësues ligjor dhe i koalicionit dhe i Lëvizjes Socialiste për Integrim si parti udhëheqëse e këtij koalicioni, duke sjellë në vëmendje që kemi të bëjmë në vetvete me një regjistrim koalicioni zoti Rusmali. Fakti është që, të paktën në dijeninë time, po besoj se është e vërtetë kjo gjë, nuk ka një regjistrim koalicioni të subjektit politik Partia Demokratike me një parti, ose shumë parti të tjera. Kështu që i mungon legjitimiteti.

**Z. I. Rusmali:** Si është trajtuar në atë kohë, në ditën që ju e ngritët, nga Komisioneri?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** I referoheni vendimmarrjes, nr. 46 të Komisionerit, për regjistrimin e...


**Z. I. Rusmali:** Po!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Komisioneri nuk i është futur thelbit fare, duke parë debatin administrativ të bërë nga palët...

**Z. I. Rusmali:** Çështjes së legjitimitetit. Ju keni kërkuar moslegjitimitimin për të marrë pjesë në shqyrtim për subjektin Partia Demokratike. Ka mbajtur qëndrim Komisioneri?

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Ishte një seancë rutinë, zoti Rusmali.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, por a ka mbajtur qëndrim apo jo? Nuk është shprehur fare?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Nuk ka mbajtur qëndrim në dijeninë time. Nuk ka mbajtur qëndrim publik duke qenë se, vetë Komisioneri me iniciativë ka mbajtur qëndrimin ligjor, të arsyetuar dhe nga ana ime. Përsa i përket pjesës së afateve brenda të cilëve mund të bëhej një kërkesë, duke e parë kërkesën si afat maksimal ndalues, por jo si afat referues të themi. Kështu që në vetvete kërkesa ka qenë në përputhje me ato që janë parashikimet e Kodit Zgjedhor, nenit 65, 64, 66 dhe në përputhje me vetë atë që është praktika tashmë e konsoliduar e këtij institucioni.

**Z. I. Rusmali:** Ju përmendët tek elementët që i mungojnë kërkesës ankimore, përmendët faktin që mungon tregimi i provave nga ana e subjektit. Element tjetër që mungon, ka?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Shiko, në qoftë se do t'i referohemi formës së vetë kërkesës ankimore, pavarësisht se relatori e thjeshtës on duke e bërë në formë tabele, kjo është sipas meje një dispozitë administrative urdhëruese deri diku për ne palët që ankimojmë te ju, komisioni. Kështu që deri në momentin që nuk ekzistonte dhe pas momentit që vendimmarrja e Komisionit Rregullator me vendimin nr. 3/2020 bashkëlidhur rregullores tuaj për funksionimin dhe zhvillimin e seancave tuaja, ka bashkëlidhur dhe modelin KA, nëpërmjet të cilit palët duhet t'i drejtohen këtij komisioni për të bërë ankime lidhur me shkeljet

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

që ata pretendojnë se janë bërë, shkeljet që janë eksplicite në ligj të themi, zoti Rusmali. Në atë rast unë mendoj që mungon dhe vetë formati në vetvete.

**Z. I. Rusmali:** Janë këto të dyja, formati dhe mungesa e tregimit të...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Mungesa e tregimit? Por dhe neni 9 në vetvete, prapë i rregullores suaj, si e citova, pika 8, që duhet të demonstrojnë interesin. Pra, nëpërmjet veprimeve ose dokumenteve të tyre që të demonstrojnë interesin e ligjshëm.

**Z. I. Rusmali:** Në rregull! Ky është debati për interesin e ligjshëm, por po diskutonim mangësitë e dokumentit, nuk po diskutonim legjitimitetin.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Edhe vetë po të shihni tek pjesa e parë kur ju drejtohet juve ankimi, emërtesa e organit kolegjal që jeni ju, është Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që thuhet Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve. Kjo është nga ana, duhet ta rregullojnë, të themi për praktikën e tyre më shumë.

**Z. I. Rusmali:** Mirë! Në qoftë se mund t'i bëj zotit Logu një pyetje? Tani juve dhatë një përgjigje, por unë do të doja të ndaleshim shumë konkretisht tek gjëja. Vendimi i Komisionerit për regjistrimin e këtij koalicioni, çfarë interesi konkret, material të kuptueshëm, të pranueshëm prek?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Rusmali për pyetjen! Në fakt duke e lidhur dhe me atë që ju kërkuat të dini nga përfaqësuesi i subjektit zgjedhor

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

Lëvizja Socialiste për Integrim, mendoj që është e rëndësishme që të ndalemi pak tek faqja 4, e vendimit nr. 46, datë 4 shkurt 2022, që i ka dhënë përgjigje se cili është interesi i ligjshëm i Partisë Demokratike në atë proces dhe sigurisht edhe në këtë proces. Konkretisht Komisioneri shprehet “e çmoj të bazuar pretendimin në lidhje me atë se kërkesa e LSI-së cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike. Pasi sipas kësaj kërkesë kërkoi që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen e LSI-së, PDK-së dhe një subjekti tjetër me emërtimin Partia Demokratike e Shqipërisë”. Ky i fundit jo vetëm që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. “Ky i fundit jo vetëm që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor por nga ana tjetër përfshirja e një termi të tillë në koalicionin zgjedhor “Shtëpia e Lirisë” të përbërë nga LSI dhe PDK, qartazi vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 66, të Kodit Zgjedhor. Ky term është gati i njëjtë me emrin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike, e cila është pjesëmarrëse në zgjedhjet e 6 Marsit 2022”. Pra, zoti Rusmali, megjithëse Komisioneri Shtetëror pranon që kërkesa, por edhe marrëveshja e koalicionit vijnë në kundërshtim pjesërisht, po themi një pjesë e tyre vijnë në kundërshtim me kërkesën e nenit 66, të Kodit Zgjedhor, ka proceduar me pranimin e kësaj kërkesë në regjistrimin e saj.

**Z. I. Rusmali:** Kjo ka lidhje me themelin? Juve i bashkoheni arsyetimit të Komisionerit me justifikimin e interesit tuaj të ligjshëm, siç e kuptova unë?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Sa i përket interesit që ne kemi sepse në kërkesë dhe në marrëveshjen e koalicionit ka referenca të qarta ndaj Partisë Demokratike të Shqipërisë, e cila në asnjë rast dhe për asnjë moment nuk ka shprehur as vullnetin, as dëshirën për të qenë pjesë e një koalicioni të tillë. Përtej kësaj, i nderuar zoti

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.07.02.2022*

Rusmali, ka nga ana tjetër edhe një përpjekje të vazhdueshme për të krijuar konfuzion tek zgjedhësit. U tha këtu që ne kemi paraqitur një provë që ka të bëjë me një foto nga ana e një personi që pretendon të jetë kandidat dhe do ta shohim në momentin kur do të regjistrohet, kemi edhe foto të tjera, të cilat janë me logo të ngjashme pothuajse identike me Partinë Demokratike. Pra, këtë lloj konfuzioni që mund të krijohet me regjistrimin e kësaj kërkesë dhe të kësaj marrëveshjeje që përmban referenca të qarta të Partisë Demokratike të Shqipërisë, ne besojmë që më pas do përsëritet edhe në fushatë dhe kjo sigurisht që çënon drejtpërdrejt interesin e Partisë Demokratike. Zgjedhësit, votuesit duhet të jenë shumë të qartë, cilët janë kandidatët e Partisë Demokratike dhe këta kandidatë sipas dëshirës dhe vullnetit të zgjedhësve duhet të votohen në zgjedhjet e 6 marsit.


**Z. I. Rusmali:** Zoti Logu, reagimi juaj lidhur me faktin që kërkesa juaj ankimore është paraqitur jashtë modelit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për paraqitjen e kërkesave ankimore, cili është?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Rusmali, ne vlerësojmë që kërkesa jonë ankimore përmban të gjitha elementët e kërkuar qoftë nga neni 126 i Kodit Zgjedhor, qoftë nga neni 10 i rregullores së posaçme që rregullon veprimtarinë e KAS-it. Mund të ndalemi element pas elementi dhe unë mendoj që ajo që ka rëndësi...

**Z. I. Rusmali:** Por është, nuk është sipas formatit të formularit të miratuar nga KQZ-ja, për këtë biem dakord besoj apo jo?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Po, patjetër!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. I. Rusmali:** Tani ka ndonjë motiv konkret pse nuk është përdorur ai format?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Ajo që ne mendojmë se është e rëndësishme, po themi, është që një kërkesë ankimore të përmbajë të gjitha elementët e treguara nga ligji dhe nga akti nënligjor. Format i në vlerësimin tonë, mendojmë që ka qenë me qëllim, ose ka patur për qëllim që t'u shërbejë edhe atyre subjekteve zgjedhore apo individëve të cilët nuk gëzojnë, po themi njohuritë e posaçme ligjore për të bërë një kërkesë në përputhje me të gjitha kërkesat e ligjit. Nga ana jonë po themi, qoftë e imja, qoftë e zotit Kaziaj, por edhe kolegë të tjerë të cilët vijnë përpara këtij komisioni, apo vijnë në KQZ dhe janë me profesion jurist, apo kanë njohuri të posaçme ligjore, besoj që kanë gjithë mundësinë që të paraqesin një kërkesë ankimore në përputhje me ligjin pa iu referuar ndoshta pikë për pikë asaj formës modelare ose tabelare që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ka dhe një praktikë edhe në procesin zgjedhor të 25 prillit, ankesat të paktën që janë bërë nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë dhe për të cilat as nga LSI, as nga ndonjë subjekt tjetër nuk ka pasur as ndonjë kundërshti, janë paraqitur në të njëjtin format me atë që ne kemi paraqitur këtë ankim. Duke treguar qartazi të gjitha ato elemente që përmban ligji. Pra, rrethanat e çështjes, bazën ligjore, analizën ligjore, konkluzionet dhe kur kemi pasur edhe ato prova që kemi pasur. Për shembull, në faqen 6, e ftoj dhe kolegun Kaziaj të konsultojë, në paragrafin nr. 16 ne kemi treguar një provë që kërkojmë të paraqesim përpara këtij komisioni. Kështu që mendoj që kjo çështja e formës është diçka e ezauruar dhe nuk ia vlen të ndalemi, aq më tepër të ndalemi se si e kemi emërtuar ne, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve apo Komisioni Ankimeve dhe Sanksioneve, që mendoj që janë diskutim i panevojshëm, po themi, edhe për ekonomi kohe.

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Mundem zoti relator?

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Po zoti Kaziaj! Ju do i përgjigjeni pyetjeve të zotit Rusmali.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** T'u përgjigjem pyetjeve të zotit Rusmali në qoftë se lejothem dhe t'i vë në dijeni dhe kolegut që lexon *al contrario*, atë që është vullneti i KQZ-së. Pjesa e faqes 4, të vendimit nr. 46 që lexoi kolegu, nuk thotë asgjë më shumë apo asgjë më pak se vendimmarrja në thelb e vetë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili duke hequr simbolet që kolegu pretendon dhe duke parë në formë dhe në përmbajtje në përputhje me kërkesat e ligjit, kërkesën dhe marrëveshjen e cila lidh palët në vetvete. Është një akt privat midis palëve, ka regjistruar me vendimmarrje nr. 46, datë 04.02.2022, ka regjistruar dy partitë politike, LSI dhe PDK. Tani ku është këtu interesi i ligjshëm që na thotë kolegu, që e paska pranuar dhe Komisioneri? Komisioneri e ka pranuar në atë rast, për shkak se një simbol që pretendohet nga partia e zotit Logu, është i ngjashëm apo jo i ngjashëm me..., dhe mund të sjellë dhe konfuzion. Përsa i përket një pjese tjetër zoti Rusmali, bëjmë me dije se neni 10 i rregullores nr. 3/2020, nuk është që duhet lënë në vlerësim të palëve, sesi palët mund të sjellin formatin e ankimit. Kërkesë ankimore e paraqitur në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të kërkesës sipas modelit të aneksit nr. 1 që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Tani në qoftë se do të sjellim secili formularët standardë të partive tona, në një komision që është rregulluar se si duhet të jetë standardi i paraqitjes së një ankimi, i bie pastaj hajde ta bëjmë lojë.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj, ju faleminderit! Patjetër që do e marrim parasysh këtë. Edhe do t'i qortojmë palët që nuk e sjellin sipas atij modeli. Unë kam një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm? Në faqen 2, të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pra vendimit objekt ankimimi, citohet në hyrje të faqes që “në kërkesën e paraqitur në KQZ janë përcaktuar partitë përbërëse të koalicionit, ku është Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Demokratike e Shqipërisë-Komiteti i Përkohshëm i Themelimit, Partia Demokristiane dhe marrëveshja e koalicionit” ndër të tjera. Kjo marrëveshje është e depozituar në KQZ?

**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. L. Braho:** Dhe cilat janë palët e marrëveshjes? Këto që citon Komisioneri në pikën 1?


**Z. Y. Merkaj:** Po!

**Z. L. Braho:** Në rregull, faleminderit! S’kam pyetje tjetër!

**Z. K. Bele:** Kisha një pyetje që edhe për ekonomi, zoti Logu, në faqen 4, në pikën e fundit parashtresave ose të gjetjeve të vendimit të Komisionerit, Komisioneri ka parashtruar, po e citoj, “e çmoj të bazuar pretendimin, duke thënë që vjen në kundërshtim me këto kërkesa”. A mendoni se ky shtjellim dhe këto gjetje të Komisionerit, e kanë ezauruar kërkesën për.., nuk di fjalën e duhur, mbase heqjen, ose mospërfshirjen e grupimit apo subjektit Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit? Pra, në kuptueshmërinë time, Komisioneri është shprehur për mospërfshirjen e këtij subjekti të pretenduar subjekt politik në këtë marrëveshje

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.07.02.2022*

koalicioni. A mendoni që kjo është tashmë një pretendim i ezauruar? Kjo pikë? Me këtë që të jem kështu, dhe ju mos t'ju vendos, e kam parasysh parashtrimin tuaj të mëparshëm ku sqaruat se dalja me logo të ngjashme cënon. Nuk kam gjë me ato, ato mund të jenë për mendimin tim, objekt i ndonjë shqyrtimit tjetër ose jo! Është çështje tjetër, por desha vetëm lidhur me këtë fakt. Pra, kur Komisioneri e ka gjetur me vend pretendimin tuaj dhe në kuptueshmërinë time e ka pranuar. A mendoni që kjo e ezauron këtë pretendim apo jo?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Bele. Ne jemi në kushtet në fakt, që pavarësisht...

**Z. K. Bele:** Më fal, shtoj dhe faktin që ky nuk është ankuar nga pala që pretendon të regjistrohet si Komision i Rithemelimit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit për pyetjen zoti Bele! Në fakt pavarësisht, për ne po themi është pak absurde që pavarësisht se pranohet që kërkesa dhe marrëveshja e koalicionit vijnë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pranohen. Me gjithë eksperiencën, po dhe ato që kemi lexuar, dëgjuar, kur konstatohet se një akt, kërkesë, marrëveshje, etj, vihen në kundërshtim me kërkesat e ligjit, nuk kemi parë ndonjë rast që institucioni, kushdo qoftë, gjykatë, komisioner, etj, etj, vijon me pranimin e kësaj kërkesë. Pra për ne, në momentin që është pranuar që kjo kërkesë ka elemente paligjshmërie, ashtu si edhe marrëveshja e koalicionit, ka elemente paligjshmërie, se këto regjistrohen së bashku. Pra, është regjistruar kërkesa, është regjistruar dhe marrëveshja. Marrëveshja nuk është marrëveshje private, nuk është një akt që kërkon të trajtohet në mënyrë formale. Marrëveshja është një kërkesë e nenit 65, pika 3 e ligjit. Është element i

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*


rëndësishëm marrëveshja e koalicionit. Madje aktet nënligjore të vetë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kanë përcaktuar dhe çfarë duhet të përmbajë marrëveshja. Kanë përcaktuar dhe përmbajtjen e marrëveshjes, të tilla si shprehjen e qartë të vullnetit...

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Ne po i hyjmë themelit. T'i përgjigjemi pyetjes së zotit Bele!

**Z. K. Bele:** Faleminderit zoti Logu! Këtë pjesë unë e kuptova, kisha...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Bele unë doja ta mbyllja sepse në qoftë se nuk e them deri në fund mendimin, ndoshta dhe nuk kuptohem qartë. Pra, duke qenë se në vlerësimin tonë, qoftë marrëveshja, qoftë kërkesa, përmbajnë elementë paligjshmërie, Komisioneri Shtetëror nuk mund të shpikë kompetenca apo të tejkalojë kompetencat e tij dhe të futet në vullnetin e kërkuësve duke ia ndryshuar vullnetin. Kërkuësit kanë pasur për vullnet të regjistrojnë një koalicion me 3 subjekte: LSI, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, Partia Demokristiane. Në tejkalim të kësaj kompetence, Komisioneri iu dikton kërkuësve se kush duhet të jenë në koalicion dhe kush nuk duhet të jenë. Ne vlerësojmë se ky tejkalim i kompetencës, por edhe fakti që pranohet vetë nga ana e Komisionerit që është në kundërshtim me kërkesat e ligjit, janë të mjaftueshme për të vijuar më tej, ose për të proceduar me rrëzimin e kësaj kërkesë. Me rrëzimin e kësaj kërkesë në atë formë dhe me atë përmbajtje që është paraqitur nga ana e kërkuësit. Vija ndërmjet procedurës dhe themelit të çështjes është shumë e, jemi gati-gati në pamundësi për t'i qëndruar strikt, në këtë moment.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt.07.02.2022*


**Z. K. Bele:** Faleminderit! Nuk është në formë replike, por sjell në vëmendje të trupës sonë, që si në të shkuarën e largët kur ka pasur subjekte që kërkesën për regjistrim e kanë bërë edhe jashtë afateve ligjore, në kujtesën time, kjo trupë, KQZ-ja në formatin e atëhershëm e ka pranuar. Ndërsa për vullnetin e Komisionerit për të ndryshuar marrëveshje, jo më larg se në zgjedhjet e fundit, kemi pasur jo vetëm ndryshim në marrëveshje, por edhe ndryshim logosh në ndihmë të procesit, besoj e kujtojmë të gjithë.

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Mundem një gjë të fundit dhe nuk e marr më fjalën?

**Z. L. Braho:** Po, zoti Kaziaj!

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Atëherë në frymën e ligjvënësit, më vjen keq që zoti Logu e lexon sipas formatit të vet, që i paskan dhënë një kod krejt ndryshe nga ky që unë kam përpara. Unë besoj se ky është Kodi Zgjedhor, neni 65, pika 3, fjalia e tretë “marrëdhëniet midis partive pjesëtare në koalicion dhe detyrimet reciproke midis tyre, rregullohen me marrëveshjen e koalicionit”. Pra, marrëdhëniet midis partive dhe detyrimet e tyre. Çfarë do të thotë? Që detyrimet që marrin me njëra-tjetrën duke caktuar një parti udhëheqëse, një parti e cila do bëjë fushatën politike, në një zonë të caktuar, ose çdo marrëdhënie tjetër, marrëdhënie private midis partive rregullohen me marrëveshjen e koalicionit. Tani se ku e gjeti këtë histori zoti Logu, që na u dashka që marrëveshja të tregoka... Është kërkesë ajo në vetvete, pavarësisht se i bashkëlidhet marrëveshja për efekt të partisë udhëheqëse, që do udhëheqë koalicionin dhe do të ketë komunikimet, siç e patëm. Duke ju referuar dhe zotit Bele vitin e shkuar që PD-AN-ja, kishte vetëm një parti,

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

nuk ishin të gjitha pjesëmarrëse në atë koalicion që legjitimoheshin për të qenë prezente për të patur marrëdhënie me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Tani nga një gjë private në një gjë publike të detyruar, nuk e di se si e lexon Logu normën.


**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Zoti Braho, në qoftë se mundem dhe një ndërhyrje? Ndoshta për të ndihmuar dhe procesin.

**Z. I. Rusmali:** Po nuk po e ndihmoni procesin!

**Z. L. Braho:** Tani vetëm po përsërisni të njëjtat gjëra, besoj se anëtarët e KAS-it janë të qartë. Nuk e di zoti Çefa në qoftë se ka ndonjë pyetje meqenëse është larg? Po!

**Z. E. Çefa:** Në qoftë se më dëgjoni? Unë do të kisha një pyetje për të dyja palët. Më tepër për të na ndihmuar dhe ne si komision për të marrë një vendim. Ne në radhë të parë duhet të ballafaqohemi me realitetin. Praktikisht është fakt i ditur botërisht që ka një konflikt të hapur ndërmjet, po e quaj, dy rrymave në Partinë Demokratike, të cilat pretendojnë secila emrin e partisë dhe logon e partisë. Ky konflikt apo ky pretendim ende nuk ka marrë një zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore. Prandaj në rrugë gjyqësore nuk dimë nëse zyrtarisht dhe përfundimisht cila do të jetë Partia Demokratike, nga cili grupim do të përfaqësohet ajo realisht. Të dyja palët pretendojnë paligjshmërinë e veprimeve të palës tjetër. Pyetja ime konkrete është kjo. Në këto kushte a mendoni zoti Logu dhe zoti Kaziaj që një vendim i KAS-it ndoshta do të paraprinte apo do të paragjykonte më pas, apo do të zgjidhte një konflikt më të thellë në themel, që në fakt nuk i përket ta zgjidhë ky

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*


komision dhe nuk ka ky komision kompetencë ta bëjë këtë. Nuk e di nëse më kuptuat?

**Z. L. Braho:** Po, zoti Çefa të dëgjuam! Je shumë i qartë në pyetjen tënde. Palët të përgjigjen tani.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti Çefa për pyetjen tuaj! Në fakt unë besoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk është forumi për të bërë diskutime politike apo për të zgjidhur hallet e brendshme të ndonjë personi të caktuar, apo të ndonjë subjekti politik. Unë di t'ju them ju që Partia Demokratike e Shqipërisë ka paraqitur një kërkesë për regjistrimin si subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ka një vendim të datës 2 Shkurt 2022, nr. 33, që thotë “vendosi të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022, Partinë Demokratike, me kryetar zotin Lulzim Basha, me shkronja nistore PD, ose PDSH. Unë mendoj që për efekt të KQZ-së ky është një diskutim i mbyllur. Pra, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka regjistruar si subjekt zgjedhor Partinë Demokratike të Shqipërisë, kryetari i saj është zoti Lulzim Basha. Përfaqësues i këtij subjekti zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të mbrojtur interesat e ligjshme të këtij subjekti zgjedhor është zoti Sefa dhe në raste kur ai nuk është i mundur do të jem unë për të përfaqësuar interesat. Kështu që mendoj që këtu nuk ka një diskutim të tillë. Pra, nuk diskutojmë këtu ndonjë debat të brendshëm apo ndonjë konflikt të brendshëm që vijmë dhe i adresojmë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të kujdeset për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Duhet të garantojë që zgjedhësit, votuesit të jenë sa më të qartë dhe të shmangin çdo lloj konfuzioni që përpiqet të krijohet nga ana e kujtdo. Kështu që qëllimi ynë primar

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*





**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve**

**Dt.07.02.2022**

në këtë çështje është që ata zgjedhës, të cilët në datën 6 mars, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje duan të votojnë Partinë Demokratike dhe kandidatët e saj, të jenë shumë të qartë kush janë kandidatët e saj dhe si mund të votohen ata. Këtë lloj konfuzioni ne mendojmë që e krijon qoftë kjo kërkesë, ashtu dhe marrëveshja që i është bashkëlidhur asaj, e cila në përmbajtje të saj ka elementë paligjshmërie, siç janë pranuar nga ana e vetë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do t'i kërkoja në fakt, meqenëse u hap këtu, do të kërkoja edhe nga ana e KQZ-së dhe secilit prej organeve të tij që t'i qëndrojë larg çfarëdolloj debati apo aludimi që mund të krijohet nga palët tjera, që pastaj jam i bindur që do të cënojnë edhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Besoj që është shumë e qartë vetë KQZ-ja me vendimmarrjet e saj se kush është subjekti zgjedhor që ka kërkuar të regjistrohet Partia Demokratike e Shqipërisë dhe cilat janë organet drejtuese të saj. Kush ka legjitimitetin përpara këtij komisioni dhe përpara të gjitha institucioneve dhe organeve të tjera publike.

**Z. L. Braho:** Faleminderit zoti Logu! Ju zoti Kaziaj keni ndonjë përgjigje?

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Patjetër zoti Braho! Zoti Çefa ju përshëndes! Fakti është që përgjigjen më së miri të pyetjes suaj do ta japin zgjedhësit në datën 6 Mars 2022, se kush është një dhe kush është tjetër. Pavarësisht replikave që mund të kemi ne në këtë komision, tashmë qytetarët e dinë fare qartë se e kanë parë se kush mbush dhe kush zbraz.

**Z. L. Braho:** Zoti Kaziaj! Do të jepni përgjigje konkrete, se nuk jemi këtu për të fol politikisht!

**Zbardhi materialin audio**

**Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

**Z. A. Kaziaj, përfaqësues i Koalicionit SH-L-së:** Ju kërkoj ndjesë zoti Braho! Ju kur filloni seancat dëgjimore shumë shpejt jeni shumë tempestiv në... Ju kërkoj ndjesë! Përsa i përket pjesës se çfarë jemi thirrur për të shqyrtuar ditën e sotme, zoti Çefa, unë nuk dua t'i përgjigjem pyetjes, do të ma lejoni këtë gjë. Për të qëndruar te fakti i një kërkesë paraprake të bërë, ku duhet të shohim elementë të formës, të legjitimitetit dhe të përmbajtjes, në rast se këto mungojnë, është e kotë që të vazhdojmë, me sqarime të tjera, për shkak se ka mangësi të theksuara të këtyre elementeve, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Zoti Çefa keni ndonjë pyetje tjetër apo jeni i qartë?

**Z. E. Çefa:** Jo, faleminderit!

**Z. L. Braho:** Atëherë, në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, besoj jemi të qartë. Pala ankimuese kërkon kalimin për shqyrtim. Pala e interesuar kërkon moskalimin për shqyrtim. Kështu që ne do të tërhiqemi për vendim. Besoj për 5 minuta do të dalë vendimi. Kështu që ju lutem, prisni jashtë.

**Rifillon seanca**

**Ora 10:00**

**Z. L. Braho:** Atëherë, riçelim seancën e verifikimit paraprak në lidhje me Kërkesën Ankimore nr. 02, datë 05.02.2022, të subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë. KAS-i pasi u tërhoq për vendim, me shumicë votash vendosi: mospranimin e Kërkesës Ankimore nr. 02, datë 05.02.2022, të subjektit

*Zbardhi materialin audio*

*Merjeta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.07.02.2022*

zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë. Ndaj këtij vendimi bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative Tiranë, sipas afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Seancën e deklarojmë të mbyllur!

**Vendimi nr. 6**

*Zbardhi materialin audio*

*Merita DULAKU*

